

BANKA E SHQIPËRISË
SIMBOLIKA E KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE



NJË HISTORI E SHKURTËR E MONEDHËS TONË KOMBËTARE

Historia e monedhës kombëtare shqiptare nis në një kohë me krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, e konstituuar më 2 shtator të vitit 1925. Banka u krijua me nënshkrimin e konventës përkatëse midis grupit financiar italian, të kryesuar nga Mario Alberti, dhe Qeverisë së Ahmet Zogut. Konventa përcaktonte ndër funksionet e këtij institucioni, përveç kreditimit, emetimin e kartëmonedhave me kurs ligjor për pagesat në Shqipëri, si dhe emetimin e monedhave të arit dhe të metaleve të tjera, me të drejtë ekskluzive. Ky mund të quhet institucioni i parë emetues kombëtar i parasë, por historia e popullit tonë dëshmon prerjen e monedhave të para që në shekullin IV p.e.s., nga Dyrrahu (Durrësi) dhe Apollonia (Pojan pranë Fierit), qytete të Ilirisë.

Për herë të parë, Shqipëria pati një institucion të bankës qendrore në vitin 1913, si rezultat i marrëveshjes së Qeverisë së Ismail Qemalit, me Karol Pitner e Oskar Pollak, përfaqësues të grupit bankar austro-hungarez të Wiener Bank Verein, si dhe me Pietro Fenolio e Guido Ansbaher, përfaqësues të grupit bankar italian të Banca Commerciale Italiana. Ky institucion nuk jetoi gjatë për vetë kushtet politike të kohës dhe për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore.

Në vitin 1925 kur u krijua banka, në Shqipëri qarkullonin një mori monedhash të vendeve të ndryshme, ndaj Banka Kombëtare e Shqipërisë mori masa për t'i zëvendësuar këto me monedhën e vetme shqiptare. Si njësi monetare zyrtare u caktua Frangu ar, me nënfishat e tij (Leku dhe Qindarka, ku 1 frang ar ishte baras me 5 lekë dhe 100 qindarka) dhe shumëfishat e tij 5, 20 dhe 100 franga ari.

Kartëmonedha e parë e emetuar ishte ajo me prerje 5 Lekë/1 Frang ar. Ajo rezultoi jetëshkurtër për shkak të kundërshtimeve të shprehura nga qeveria shqiptare e kohës mbi shqipjonjën e paraqitur në të, e cila në dallim nga shqipjonja dykrenare, simbol i kombit tonë, paraqiste shqipjonjën me një kokë sipas stilit romak.

Përgjatë vitit 1926, Banka Kombëtare e Shqipërisë emetoi dhe hodhi në qarkullim:

- kartëmonedhat me prerje 5 Franga ari, 20 Franga ari dhe 100 Franga ari;
- monedhat ar 20 Franga ari dhe 100 Franga ari, monedhat argjend 2 Franga ari dhe 5 Franga ari, dhe monedhat e tjera 5 Qindar leku, 10 Qindar leku, $\frac{1}{4}$ Lek, $\frac{1}{2}$ Lek dhe 1 Lek.

Me fundin e Luftës së Dytë Botërore, të gjitha funksionet dhe detyrimet e Bankës Kombëtare të Shqipërisë pushuan së ekzistuari. Vetë banka u shtetëzua dhe në vitin 1945, u krijua Banka e Shtetit Shqiptar.

Viti 1947 shënon një moment të rëndësishëm për monedhën tonë kombëtare. Me dekretligjin e datës 7 korrik 1947, si njësi monetare caktohet Leku, i cili zëvendësoi Frangun, ndërsa ky i fundit tërhiqet përfundimisht nga qarkullimi. Që nga ky moment, kartëmonedha Lek ndryshon herë pas here simbolikën dhe përmasat.

Moment tjetër i rëndësishëm në historinë e monedhës tonë kombëtare është viti 1965, vit në të cilin ndryshoi raporti midis prerjes lek të përdorur që nga viti 1947 me atë të emetuar në këtë vit në raportin 10 lekë (vitet 1947, 1957) = 1 lek (viti 1964 e në vazhdim). Gjithashtu, për herë të parë shtypen dhe hidhen në qarkullim nënfisha të lekut, qindarkat.



Ardhja e vitit 1991 do të sillte ndryshime edhe në elementet e sigurisë së kartëmonedhave, ku për herë të parë vendoset filli i sigurisë në kartëmonedhën 100 Lekë.

Banka e Shqipërisë krijohet në vitin 1992 si banka qendrore e vendit dhe sistemi bankar ndahet në dy nivele. Ndër funksionet e saj kryesore, theksohet edhe roli si emetuese e vetme e kartëmonedhës dhe monedhës kombëtare me kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Që në vitin e parë të krijimit, Banka e Shqipërisë, nën ndikimin e ndryshimeve të mëdha socio-politike në vend, përballlet me domosdoshmërinë e rritjes së sasisë së monedhës në qarkullim, si dhe ndryshimin e strukturës së prerjeve të saj. Emetimet e këtij viti ndryshojnë në tematikë për shkak të mosdiktimit nga sistemi politik. Gjithashtu, për herë të parë në emetimet e pasluftës, vendosen në kartëmonedha firmat e Guvernatorit dhe të Drejtorit të Departamentit të Emisionit dhe Administrimit të Parasë.

Vitet në vijim, shënojnë një rritje të vazhdueshme të kërkesës së ekonomisë për para. E shtyrë nga përgjegjësia për t'iu përgjigjur më së miri kësaj kërkeje me një strukturë të përshtatshme prerjesh, Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 1995, kreu studime për një emision të ri të monedhës dhe kartëmonedhës. Ky emision u projektua tërësisht i ri në tematikë, me një seri monedhash metalike të përbërë nga 6 prerje: 1, 5, 10, 20, 50 dhe 100 Lekë; dhe seri kartëmonedhash të përbërë nga 5 prerje: 100, 200, 500, 1000, 5000 Lekë, të cilat u rishtypën duke përmirësuar elementet e sigurisë, për të rritur besueshmërinë ndaj parasë dhe për të shmangur falsifikimin. Në rishtypjet e kartëmonedhave është ruajtur pamja (vizatimet e tyre), por janë përmirësuar elementet e sigurisë dhe kanë ndryshuar firmat e drejtuesve.

Në vitin 2019, Banka e Shqipërisë prezantoi për publikun dy kartëmonedhat e para të serisë së re prej 6 kartëmonedhash, prerjet 200 Lekë dhe 5000 Lekë, për të vijuar më pas, në qershor 2021, me hedhjen në qarkullim të prerjeve 1000 Lekë dhe 10000 Lekë, e në janar 2022, të prerjeve 500 Lekë dhe 2000 Lekë. Pas më shumë se 20 vitesh, dizenjimi i kartëmonedhave të qarkullimit vjen i rifreskuar, me elemente sigurie të përmirësuara, duke i dhënë kartëmonedhës shqiptare një pamje më moderne, më rezistente,

me cilësi, integritet dhe besueshmëri të lartë, të krahasueshme me ato të vendeve më të përparuara. Gjithashtu, kartëmonedha me prerje 200 Lekë vjen me një përbërje të re, në polimer, një material plastik i tejdukshëm dhe i hollë, me ndjesi të veçantë në prekje.

Tematika e zgjedhur nga Banka e Shqipërisë për kartëmonedhat që kemi sot në qarkullim ndjek konceptin e pasqyimit të epokave historike nëpërmjet paraqitjes së portreteve të personaliteteve simbol të tyre.

SERIA AKTUALE E KARTËMONEDHAVE PËRFSHIN KËTO PERIUDHA:

Kartëmonedha 2000 Lekë përfaqëson periudhën ilire (portreti i Mbretit Ilir Gent)

Kartëmonedha 5000 Lekë përfaqëson periudhën e Skënderbeut (portreti i tij)

Kartëmonedha 1000 Lekë përfaqëson Mesjetën (portreti i Pjetër Bogdanit)

Kartëmonedha 200 Lekë përfaqëson Rilindjen (portreti i Naim Frashërit)

Kartëmonedha 500 Lekë përfaqëson Pavarësinë (portreti i Ismail Qemalit)

Kartëmonedha 10000 Lekë pasqyron simbolet e flamurit kombëtar dhe himnit (portreti i Asdrenit)



KARTËMONEDHA 200 LEKË

Në projektin e Bankës së Shqipërisë për të pasqyruar në kartëmonedhat e emetuara prej saj, epoka historike të rëndësishme për popullin shqiptar, duke i karakterizuar ato me personalitetet më përfaqësuese të tyre, nuk mund të lihej mënjane figura e poetit dhe atdhetarit Naim Frashëri. Ai prezantohet në kartëmonedhën 200 Lekë, emetim i vitit 1996, rishtypur në vitet 2001, 2007 dhe 2012.

Në emetimin e ri të vitit 2017, kartëmonedha 200 Lekë paraqitet e ridizenjuar dhe me elemente sigurie të përmirësuara. Risi përbën materiali në të cilin është shtypur, polimeri - një material plastik i tejdrukshëm dhe i hollë. Kjo kartëmonedhë u hodh në qarkullim për herë të parë më 30 shtator 2019.


Portreti i shkrimtarit të shquar Naim Frashëri, simbol i periudhës së Rilindjes Kombëtare, në këtë kartëmonedhë shoqërohet me elemente të tjera grafike që, në të njëjtën kohë, përmbajnë dhe përcjellin simbolikën letrare. Kjo simbolikë, në të dyja anët e kartëmonedhës, na sjell ndërmend rëndësinë e veprës së Naim Frashërit dhe dashurinë ndaj atdheut, shprehur nëpërmjet veprimtarisë së tij letrare. Kështu, në anën e përparme të kartëmonedhës gjejmë në plan të parë portretin e shkrimtarit dhe në sfond një libër të hapur. Ndërsa, në anën e prapme është vendosur pamja e shtëpisë ku ka lindur Naim Frashëri, një fletë ku janë shkruar vargjet e tij: “Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin Shqipëtar” dhe një përfytyrim artistik i penës së tij.

200



NAIM FRASHËRI 1846-1900

BANKA E
SHQIPËRISË



DYQIND LEKË 200

NAIM FRASHËRI - JETA DHE KONTRIBUTI

Naim Frashëri (1846-1900) lindi në Frashër të Përmetit. Atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar në fushën e arsimit dhe kulturës shqiptare, ai mbetet poeti më i madh i Rilindjes tonë Kombëtare. E gjithë veprimtaria e tij letrare dhe kulturore lidhet ngushtë me çlirimin dhe përparimin e vendit, me çlirimin shpirtëror dhe ndrigimin e masave të popullit. Naim Frashëri luajti një rol themelor në pasurimin e gjuhës letrare shqipe, të cilën e shkroi me një përkushtim të veçantë ndaj fjalorit dhe frazeologjisë së përzgjedhur. Duke u mbështetur kryesisht në gjuhën e popullit, Naimi shkroi në një shqipe të pastër dhe bëri një punë të dukshme për pasurimin e saj, duke e ngritur atë në lartësinë e një gjuhe të zhvilluar, e cila mbetet një pasqyrë e mendjes dhe shpirtit krijues të autorit.

Krijimtaria e tij është dukshëm e frymëzuar nga një patriotizëm i thellë dhe një dashuri e mirëshprehur për natyrën e vendit tonë. Ai ishte një nga themeluesit kryesorë të revistës "Drita" (më pas "Dituria"), ku botoi krijimet e para në poezi, proza diturore e vjersha për shkollat e para, si dhe shqipërimi. Me përkushtimin dhe veprimtarinë e dendur atdhetare dhe kulturore, Naim Frashëri u bë figura qendrore e Rilindjes Kombëtare dhe u pagëzua për së gjalli si "Apostull i Shqiptarizms".

Vdiq në Stamboll më 20 tetor 1900. Eshtrat e tij u sollën në atdhe më 1937 dhe prehen në Memorialin e Rilindësve në Tiranë.

Mes veprave të tij të shumta që kontribuan në pasurimin e letrave shqipe, e që sot përbëjnë themelet e kulturës sonë kombëtare, radhiten "Fjalët e qiriit", "Istori e Skënderbeut", "Luletë e verësë", "Qerbelaja" etj. Pa dyshim, vepra e tij më e njohur poetike mbetet "Bagëti e bujqësija", nga ku janë marrë dhe fjalët e shkruara në pjesën e pasme të kartëmonedhës 200 Lekë, që përbëjnë një himn të vërtetë letrar, i cili përcjell gjithë dashurinë, përkatësinë dhe krenarinë e autorit për atdheun.



NAIM FRASHËRI 1846-1900

200

BANKA E SHQIPËRISË

200


AA000000



*Ti Shqipëri
më jep nder,
më jep emrin Shqiptar*



2017



Geart Ljeto
GUVERNATORI

Abdullah
DREJTORI

DYQIND LEKË AA0000000

KARTËMONEDHA 500 LEKË


Emetimi i parë i kartëmonedhës 500 Lekë me tematikën që ka sot, daton në vitin 1996. Ajo është rishtypur në vitet 2001, 2007 dhe 2015, me të njëjtën pamje dhe përmasë. Emetimet e reja synojnë shtimin dhe përmirësimin e elementeve që kanë të bëjnë me sigurinë dhe qëndrueshmërinë ndaj dëmtimeve e falsifikimit, si dhe ndryshimin e firmave të Governorit dhe Drejtorit të Departamentit të Emisionit.

Në serinë e re, kartëmonedha 500 Lekë, me vit emetimi 2020, paraqitet e ridizenjuar dhe me elemente sigurie të përmirësuara.

Në anën e përparme të saj është vendosur portreti i Ismail Qemalit, simboli i shqiptarëve dykrenarë të flamurit të pavarësisë, së bashku me penën me të cilën u nënshkrua akti i pavarësisë. Ndërsa në anën e prapme, është zgjedhur të vendoset ndërtesa ku zhvilloi punimet Qeveria e Përkohshme e Vlorës, sot Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, një përfytyrim artistik i tryezës ku u nënshkrua vendimi dhe telegrafi me të cilin u shpërnda lajmi i shpalljes së Pavarësisë.

ISMAIL QEMALI - JETA DHE KONTRIBUTI

Ismail Qemali lindi në Vlorë, më 1844. Që në moshë të re punoi në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane dhe, pas përfundimit të studimeve për jurisprudencë, mbajti funksione të rëndësishme administrative në perandori. Këto poste i përdori për të ndihmuar lëvizjen çlirimtare shqiptare: mori pjesë në përpjekjet për krijimin e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe dhe për formimin e një shoqërie kulturore shqiptare. Karriera e tij politike dhe përpjekjet e bëra në ndihmë të popullit tonë për të arritur pavarësinë, e bënë atë një udhëheqës të shquar të lëvizjes kombëtare dhe gjithashtu, pas nënshkrimit të Pavarësisë, edhe kryeministër të Shqipërisë së pavarur.





BANKA E SHQIPËRISË



500



ISMAIL QEMALI 1844-1919

PESËQIND LEKË 500



ALBANIA

Pas shpalljes së Pavarësisë, qeveria shqiptare e kryesuar nga Ismail Qemali, vendosi si një nga objektivat parësorë të saj, krijimin e një banke emetimi dhe krediti në Shqipëri, e cila do të ndiqte shembullin e bankave kombëtare të shteteve evropiane. “E them me lavdurim” – vinte në dukje ai në fjalimin që mbajti në sheshin e mbledhjes në Vlorë – “se puna e Bankës për Shqipërinë është një i dyti fitim, pas lirisë, edhe nga pikëpamja ekonomike dhe politike”. Banka kombëtare konceptohej nga Ismail Qemali si një institucion financiar që synonte zhvillimin ekonomik të vendit, por, në mungesë të stabilitetit në vend, nuk u krijuan mundësitë për formimin e një banke me kapital themeltar shqiptar. Kjo e detyroi Ismail Qemalin të kërkonte ndihmën e Austro-Hungarisë dhe të Italisë. Banka Kombëtare e Shqipërisë, me kapital të përbashkët austro-italian, kishte të drejtën e emetimit të kartëmonedhave, të cilat do të emërtoheshin në shqip dhe në frëngjisht, dhe do të mbante në rezervë mjaftueshëm ar sa për të mbuluar 1/3 e kartëmonedhave në qarkullim. Në këtë moment, Banka mori rolin e agjentit financiar të qeverisë shqiptare, duke fituar kështu të drejtën e kryerjes së disa veprimeve financiare në emër të qeverisë e për të tregtuar për llogari të saj.

Me nënshkrimin e konventës bankare më 4 tetor 1913, Ismail Qemali ishte i bindur se Banka Kombëtare e Shqipërisë e krijuar dhe e financuar nga Austro-Hungaria dhe Italia, do të çonte drejt zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe konsolidimit të pavarësisë dhe Shtetit Shqiptar. Megjithatë, problemet me të cilat u ndesh Shqipëria gjatë kësaj periudhe nuk krijuan mundësi për zhvillimin e Bankës Kombëtare, veprimtaria e së cilës u ndërpre përfundimisht në qershor të vitit 1914.

Ismail Qemali i dedikoi gjithë jetën e tij çështjes kombëtare dhe krijimit të shtetit shqiptar. Vitet e fundit i kaloi në mërgim, duke punuar gjithnjë në funksion të çështjes kombëtare dhe duke bashkëpunuar me diasporën shqiptare. Vdiq në vitin 1919, në Peruxhia të Italisë. Këmbëngulja, puna dhe përkushtimi i tij për atdheun janë pritur me po aq zjarr nga populli shqiptar që vlerësoi personalitetin politik dhe madhështinë e tij me një ndjenjë të madhe respekti, e cila i reziston kohës.

500

BANKA E
SHQIPËRISE


A
A
O
O
O
O
O
O
O



Geart Lejko
GUVERNATORI

Arbana
DREJTORI

PESËQIND LEKË



500

2020

AA000000

KARTËMONEDHA 1000 LEKË

Kartëmonedha 1000 Lekë, emision i vitit 1996, është rishtypur në vitet 2001, 2007 dhe 2011, duke ruajtur pamjen dhe përmasat. Në riprintimet e reja të kësaj prerjeje, ashtu si në riprintimet e të gjitha prerjeve, janë shtuar apo përmirësuar elemente që kanë të bëjnë me sigurinë dhe me qëndrueshmërinë ndaj dëmtimeve, si dhe janë reflektuar ndryshimet e firmave të Guvernatorit dhe Drejtorit të Departamentit të Emisionit.

Në serinë e re, kartëmonedha 1000 Lekë, me vit emetimi 2019, paraqitet e ridizenjuar dhe me elemente sigurie të përmirësuara.


Kartëmonedha ka, në anën e përparme, portretin e Pjetër Bogdanit, shkrimtar, klerik e figurë e shquar e letërsisë së vjetër shqiptare, të marrë nga frontespici i veprës së tij “Çeta e profetëve” (*Cuneus prophetarum*), si dhe një skicë të tij të diellit.

Në anën e prapme, në qendër të kartëmonedhës paraqitet një simbol i idesë së Bogdanit mbi eklipsin e hënës. Në të djathtë është vendosur një pamje e kishës katolike të Vaut të Dejës dhe vlera e kartëmonedhës.

PJETËR BOGDANI - JETA DHE KONTRIBUTI

Pjetër Bogdani (1625-1689) përbën një nga figurat më të shquara të letërsisë shqiptare të Mesjetës. Ai lindi në Gur të Hasit, në afërsi të Kukësit. Pas përfundimit të studimeve për teologji dhe filozofi në Romë, ku merr edhe titullin doktor, emërohet fillimisht ipeshkv në Shkodër dhe më pas kryepeshkv i Shkupit.

BANKA E
SHQIPËRISË



PJETER BOGDANI 1625-1689

NJË MIJË LEKË

1000





PJETËR BOGDANI 1625-1689

Në kohën kur Pjetër Bogdani fillon krijimtarinë e tij, prozës shqiptare i mungonte tradita në shprehjen e nocioneve në fusha të ndryshme të dijes. Por, Bogdani besonte tek pasuria e gjuhës shqipe. I frymëzuar nga ndjenja patriotike, fetare dhe artistike, ai mbledh me kujdes fjalë të lashta e të rralla të gjuhës tonë, i përdor ato me kuptim të drejtpërdrejtë ose të figurshëm, duke ngritur gjuhën shqipe në nivele të reja. Vepra e tij më e njohur, me përmbajtje kryesisht teologjike e filozofike, “Çeta e profetëve” është një nga gurët themeltarë të trashëgimisë sonë letrare dhe përfaqëson një moment historik shumë domethënës për gjuhën shqipe.

Me kulturën e tij të gjerë enciklopedike, me mendimet e tij përparimtare e atdhetare, me punën e gjatë këmbëngulëse, Bogdani i dha letërsisë shqiptare dhe popullit shqiptar një vepër madhore, që hodhi në letër traditën gjuhësore e kulturore dhe paralajmëroi një periudhë të re të zgjimit gjithëkombëtar. Ai ishte një mendimtar i kohës së tij. Me artin e tij letrar, ai rikthen në të njëjtën kohë pasuritë gjuhësore dhe dinjitetin kombëtar.

Filozofia e jetës dhe e veprës së Pjetër Bogdanit paraqet më së miri atë që, krahas vlerës materiale, është një vlerë e shtuar e monedhës tonë kombëtare: rolin thelbësor të monedhës si element i ndërgjegjes së përbashkët kulturore.

1000

BANKA E SHQIPËRISË

AA000000



Geart Lajthi
GUVERNATORI

Arbën Haxhiu
DREJTORI

NJË MIJË LEKË



1000

2019

AA000000

KARTËMONEDHA 2000 LEKË

Kartëmonedha me vlerë 2000 Lekë, emetuar për herë të parë si prerje e re në vitin 2007 dhe e rishtypur në vitin 2012, mban portretin e Mbretit ilir Gent. Ajo paraqet elementin e fundit të mbetur jashtë tablosë së vlerave të së shkuarës, që Banka e Shqipërisë ka dashur të prezantojë në përzgjedhjen e personaliteteve përfaqësuese të periudhave historike më domethënëse për vendin tonë, lashtësinë.

Në serinë e re, kartëmonedha 2000 Lekë, me vit emetimi 2020, paraqitet e ridizenjuar dhe me elemente sigurie të përmirësuara.

Në pjesën e përparme, kartëmonedha mban portretin e Mbretit ilir Gent dhe dy monedha të prera prej tij, ndërsa në anën e pasme paraqitet bima medicinale *Gentiana lutea*, aftësitë kuruese të së cilës janë zbuluar prej tij dhe një vepër të arkitekturës së antikitetit.


MBRETI GENT - JETA DHE KONTRIBUTI

Burrë shteti, luftëtar, dijetar në fushën e shëndetësisë dhe mjek, Mbreti ilir Genti sundoi në vitet 181-168 p.e.s, në një periudhë të karakterizuar nga konflikti dhe kontradiktat midis shteteve të pellgut ballkanik, nga njëra anë, dhe Romës nga ana tjetër. Ai mishëron lashtësinë e prejardhjes së vlerave tona kulturore kombëtare, të cilat theksojnë historinë mijëra vjeçare iliro-shqiptare si dhe evidentojnë vjetërsinë e saj në kontinentin evropian.

Një tjetër veçori që e bën figurën e Gentit edhe më komplekse e të plotë, është vizioni i tij i qartë mbi veprimet që duheshin marrë për forcimin ekonomik dhe politik të mbretërisë, e cila në atë kohë kishte si



2000



DY MIJË
LEKË



MBRETI GENT 181-168 p.e.s.

BANKA E SHQIPËRISË



DY MIJË LEKË 2000

kryeqytet Shkodrën. Faktet historike dëshmojnë një veprimtari të dendur monedhëprerëse, të zhvilluar nga mbreti Gent. Ai ndaloi prodhimet e monedhave të ndryshme nga qytetet ilire dhe krijoi një sistem të përbashkët monetar në mbretërinë e tij. Për këtë qëllim, ai ndërpreu prerjet e vjetra të punishtes së Shkodrës dhe në vend të tyre hodhi në treg monedha të reja, të cilat paraqisnin në pjesën e përparme portretin e mbretit dhe në pjesën e prapme simbolin e anijes ilire liburne dhe emrin e mbretit. Pikërisht, elementi i portretit të mbretit u rimor edhe në kartëmonedhën 2000 Lekë.

Genti vazhdoi të presë edhe monedhën e Shkodrës me mburojë e përkrenare, të kohës së Pleuratit, por edhe kësaj i vuri titullin dhe emrin e tij. Duke i hequr autonominë monetare Shkodrës e Lisit, e duke i kthyer punishtet e tyre në punishte mbretërore, u siguruan kushtet për krijimin e sistemit të vetëm monetar, të përbërë nga tre monedhat. Kjo politikë e ndjekur nga mbreti Gent e lejoi atë të përqendrojë në duart e tij mjete financiare të fuqishme. Dëshmi e kësaj fuqie financiare është përmbajtja e thesarit mbretëror të sekuestruar nga romakët. Historiani romak Tit Livi thotë se në arkën e mbretit u gjetën 27 ponde ari, 19 ponde argjendi, 13.000 denarë dhe 12.000 monedha argjendi ilire.

Përpjekja për të fuqizuar arkën shtetërore diktohej në radhë të parë nga rreziku romak, duke dhënë prova të një politike energjike dhe një sistemi të mirorganizuar ekonomik.

Në vitin 168 p.e.s, i gjetur nën sulmin e Romës, ai i priti forcat pushtuese në afërsi të qytetit Basania, në jug të Lisit, ndërsa qëndresa e fundit ilire u zhvillua në kryeqendrën e Mbretërisë, në Shkodër. Pas përfundimit të luftimeve me disfatë të forcave ilire, Genti u dërgua në Romë, së bashku me familjen e tij, robërit dhe plaçkën e luftës ndër të cilat numëroheshin rreth 200 anije.

Ai vdiq në vitin 146 p.e.s në qytetin Iguvium (Gubbio e sotme) të Italisë.

2000

BANKA E
SHQIPËRISË

K
A
O
O
O
O
O
O



2020

2000

Geant Lajto
GUVERNATORI

Arben
DREJTORI



DY MIJË LEKË

KA0000000

KARTËMONEDHA 5000 LEKË

Kartëmonedha 5000 Lekë është emtuar për herë të parë në vitin 1996. Ajo është rishtypur tre herë, në vitet 2001, 2007 dhe 2013, me të njëjtën pamje dhe përmasë, por me elemente të përmirësuara sigurie dhe me ndryshime të firmave të Guvernatorit dhe Drejtorit të Departamentit të Emisionit.

Në serinë e re, kartëmonedha me prerje 5000 Lekë, me vit emetimi 2017, paraqitet me një dizeno të rifreskuar dhe elemente sigurie shtesë. Si edhe emetimet ekzistuese në qarkullim, ajo është shtypur me letër sigurie të cilësisë së lartë me përbërje pambuku.

Personaliteti simbol i kësaj kartëmonedhe është zgjedhur Gjergj Kastrioti (Skënderbeu), heroi ynë kombëtar dhe figura më e shquar e historisë së popullit shqiptar, portreti i të cilit shquhet në pjesën e përparme të kartëmonedhës. Në anën e pasme është vendosur pamja e përgjithshme e Kështjellës së Krujës, përkrenarja dhe monumenti i Skënderbeut mbi kalë, që ndodhet në qendër të Tiranës, vepër e skulptorit Odhise Paskali.

GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU - JETA DHE KONTRIBUTI

Skënderbeu (1405-1468) përmbledh një epokë të tërë historike nën emrin e tij. Me Skënderbeun në pozicionin e udhëheqësit të lëvizjes, lufta e shqiptarëve kundër pushtimit osman u ngrit në një shkallë më të lartë e të mirorganizuar, e cila solli një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të Shqipërisë. Ai është përfaqësuesi më i shquar në luftën kundër pushtuesve osmanë dhe në krijimin e Lidhjes Shqiptare të Lezhës, lidhje e cila hapi rrugën e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar.





1000000



SKËNDERBEU, 1405-1468

BANKA E SHQIPËRISË



PESË MIJË LEKË 5000

1468

Rëndësi të veçantë, ai i kushtoi ruajtjes së burimeve të brendshme ekonomike tek të cilat mbështetej lufta. Me fuqizimin e mbrojtjes së brezit kufitar, ai u dha mundësinë viseve të lira të zhvillonin një veprimtari ekonomike deri diku normale. Krahas mbrojtjes së vendit, forcat e Skënderbeut u angazhuan në çlirimin e viseve të pushtuara, veprim i cili ndihmoi në forcimin e bashkimit dhe të gjithë popullit shqiptar. Duke kuptuar pabarazinë e theksuar midis forcave shqiptare dhe atyre osmane, ai zhvilloi strategjinë e tij luftarake që bazohej edhe në kërkesën e pareshtur për pjesëmarrje, bërë vendeve evropiane, në luftën kundër armikut të përbashkët. Dokumentet historike të shek. XV hedhin dritë mbi marrëdhëniet diplomatike të vendosura e të ruajtura nga Skënderbeu ndër vite. Bashkëpunimi me shtete si: Republika e Venedikut, Shteti Papal, Mbretëria e Napolit dhe Republika e Raguzës, natyrshëm solli edhe intensifikim të veprimeve financiare me to. Marrëdhënie financiare kanë ekzistuar edhe me sulltanin, ku përmendet kthimi, në këmbim të një shpërblimi monetar, i ushtarëve turq të zënë rob gjatë luftës. Veprimet financiare të Skënderbeut me shtetet e huaja kryheshin kryesisht me para në dorë nga kryearketari, që shërbente si ministër i financave. Ai mbante llogari mbi të ardhurat dhe shpenzimet e shtetit.

Principata e Kastriotëve, nën sundimin e Skënderbeut, përfshiu në një shtet plotësisht të pavarur pjesën më të madhe të trojeve shqiptare të pushtuara nga osmanët. Lidhja e Lezhës u bë i pari bashkim politik në shkallë kombëtare në historinë e Shqipërisë. Skënderbeu u zgjodh kryetar i Lidhjes dhe Komandant i përgjithshëm i saj. Trojet shqiptare mundën t'u bënin ballë vërshimeve të njëpasnjëshme, betejave masive, bllokadave dhe rrethimeve që organizuan Murati II dhe i biri, Mehmeti II, për më shumë se 25 vjet.


Skënderbeu vdiq i sëmurë në Lezhë dhe u varros po aty në vitin 1468.

Simbol i luftës për liri e pavarësi, dhe udhëheqës me vizion të qartë në përpjekjet për bashkimin e trojeve shqiptare, për shekuj me radhë, Skënderbeu ka qenë pjesa më e rëndësishme e historisë dhe e dinjitetit tonë kombëtar. Figura historike e Skënderbeut dhe çka ajo përfaqëson ka zënë vend në veprat e shumë artistëve, vendas e të huaj, në skulpturë, pikturë, letërsi e kinematografi, dhe padyshim, nuk mund të mungonte në serinë e kartëmonedhave të emetuara nga Banka e Shqipërisë.

5000

BANKA E SHQIPËRISË

NA000000



5000



2017

Geart Sejko
GUVERNATORI

Arif Ahmeti
DREJTORI

PESË MIJË LEKË

NA0000000

KARTËMONEDHA 10000 LEKË

Në muajin qershor 2021, u hodh në qarkullim për herë të parë kartëmonedha shqiptare me vlerë më të madhe, prerja 10000 Lekë, emetimi i vitit 2019, duke e pasuruar kështu serinë e kartëmonedhave me një prerje tërësisht të re, në përputhje me nevojat aktuale të ekonomisë sonë.

Personaliteti i pasqyruar në kartëmonedhë është poeti dhe patrioti i njohur Aleksandër Stavre Drenova, i njohur me pseudonimin Asdreni. Në linjë me kartëmonedhat e tjera të serisë, të cilat nderojnë figurat kryesore me rol kyç në historinë dhe shtetformimin tonë, tematika e trajtuar në kartëmonedhën 10000 Lekë janë simbolet më të rëndësishme kombëtare: flamuri dhe himni kombëtar, përfaqësuar me autorin e tekstit të këtij të fundit. Në pjesën e përparme të kartëmonedhës shquhet portreti i Asdrenit, ndërsa në pjesën e pasme paraqitet flamuri, një gramafon, nota muzikore në pentagram dhe dy vargjet e para të himnit të flamurit "Rreth flamurit të përbashkuar, me një dëshirë e një qëllim".

Me hedhjen e kësaj kartëmonedhe në qarkullim, seria e kartëmonedhave shqiptare tashmë ka 6 prerje: 200, 500, 1000, 2000, 5000 dhe 10000 Lekë.

ASDRENI - JETA DHE KONTRIBUTI

Poeti e patrioti i shquar Aleksandër Stavre Drenova, njohur në letërsinë tonë me pseudonimin Asdreni, lindi më 11.4.1872 në Drenovë të Korçës, në një familje të varfër fshatare. I mbetur jetim, u detyrua të braktisë shkollën e mesme dhe të mërgojë në Rumani më 1885. Ndërsa siguronte me punë jetesën, kreu Akademinë Tregtare të Bukureshtit dhe më pas u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Politike të universitetit të atjeshëm, të cilin nuk arriti ta përfundonte.



10000

BANKA E QIPËRISË



ASDRENI

MIJË LEKË

10000

ASDRENI, 1872-1947

DHJETË

Ai ka qenë veprimtar i shquar i kolonisë shqiptare të Rumanisë dhe sekretar i saj (1913-1925); në periudhën 1922-1934 shërbeu, me ndërprerje, si sekretar i Konsullatës Shqiptare në Rumani. Asdreni mori pjesë në mbledhjen e Bukureshtit të 5 nëntorit 1912, në të cilën u vendos të shpallej pavarësia e Shqipërisë.

Asdreni nisi të shkruante poezi dhe publicistikë nga fillimi i shekullit XX dhe krijimet e para poetike i përmbodhi në librin "Reze dielli" (1904). Njihet si vijues i traditës së poezisë së Naim Frashërit, ku lartësohej dashuria për atdheun dhe nxitej lufta për mëvetësim nga Perandoria Osmane. Vepra më e rëndësishme e tij, "Ëndrra e lotë" (1912), shquhet për pasurinë e motiveve, frymën demokratike dhe nivelin e lartë artistik. Në krijimet e këtij vëllimi, poeti i këndoi heroizmit të popullit shqiptar në kryengritjet e armatosura të viteve 1911-1912. Kjo vepër shënoi një hap në kalimin nga romantizmi te realizmi në letërsinë shqiptare. Në vitin 1931, botoi vëllimin e tretë poetik të titulluar "Psallme murgu"; përmbledhja e fundit poetike, "Kambana e Krujës", u botua mbas vdekjes (1991).

"Betimi mi flamur" e vjersha të tjera të muzikuara të tij me frymëzim atdhetar luajtën një rol të shënuar në forcimin e ndërgjegjes kombëtare, në prag e pas Shpalljes së Pavarësisë dhe në periudhën e konsolidimit të Shtetit Shqiptar.


Idealist i përkushtuar, Asdreni e mbylli jetën në varfëri të plotë. Vdiq në Bukuresht më 11 dhjetor 1947. Eshtrat e tij u sollën në atdhe në vitin 1972 dhe prehen në vendlindje, në Drenovë.

10000

BANKA E
SHQIPËRISË

A
A
O
O
O
O
O
O
O

10000



Genit Lajçi
GUVERNATORI

Artur Meçe
DREJTORI

*Drejt flamurit të përbashkuar
me një dëshirë e një qelëtim* 2019

DHJETË MIJË LEKË

AA0000000



EMETIMET E KARTËMONEDHAVE EKZISTUESE

VAZHDOJNË TË QARKULLOJNË E TË KENË KURS LIGJOR SI MJET PAGESE, SË BASHKU ME KARTËMONEDHAT E REJA.



EMETIMET E REJA

HEDHUR NË QARKULLIM DUKE FILLUAR NGA 30.9.2019



